

**VENDIM**

Nr. 811, datë 21.10.2020

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT
“STANDARDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPAPËSINOR
NË SHQIPËRI – TEMA: PËRDORIMI
I TOKËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “m”, dhe 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Përdorimi i tokës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**STANDARDET SHTETËRORE
PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPAPËSINOR NË
SHQIPËRI – TEMA: PËRDORIMI I TOKËS**

PËRMBAJTJA**1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE****2. HYRJE****2.1 Qëllimi****2.2 Si lexohet dokumenti****2.3 Detyrimet ligjore****2.4 Fusha e veprimt****3. TEMA****3.1 Përdorimi i tokës****3.1.1 Parathënie****3.1.2 Terma dhe përkufizime**

3.2 Përshkrimi i nëntemës “Përdorimi ekzistues i tokës”

3.2.1 Parathënie

3.2.2 Skemat e aplikimit dhe diagrami UML për nëntemën “Përdorimi ekzistues i tokës”

3.2.3 Katalogu i tipologjisë

3.2.3.1 Grupi i të dhënave të përdorimit ekzistues të tokës i thjeshtëzuar

3.2.3.2 Objekti i përdorimit ekzistues të tokës**3.2.3.3 Përdorimi ekzistues i tokës****3.2.3.4 Përdorimi ekzistues i tokës i thjeshtëzuar****3.2.3.5 Rjeti i përdorimit ekzistues të tokës****3.2.3.6 Përqindja HILUCS****3.2.3.7 Prezenca HILUCS****3.2.3.8 Përqindja specifike****3.2.3.9 Prezenca specifike****3.2.3.10 Vlerat HILUCS**

3.2.3.11 Vlera e klasifikimit të përdorimit të tokës

3.3 Përshkrimi i nëntemës “Planifikimi i përdorimit të tokës”

3.3.1 Parathënie

3.3.2 Skemat e aplikimit dhe diagrami UML për nëntemën “Planifikimi i përdorimit të tokës”

3.3.3 Katalogu i tipologjisë**3.3.3.1 Dokumentacioni zyrtar****3.3.3.2 Element zonimi****3.3.3.3 Plani gjeohapësinor****3.3.3.4 Rregullore plotësuese****3.3.3.5 Vlerat e hartës bazë**

3.3.3.6 Vlerat e karakterit të treguesit të dimensionimit

3.3.3.7 Vlerat e plota të treguesit të dimensionimit

3.3.3.8 Vlerat e masës së treguesit të dimensionimit

3.3.3.9 Vlerat reale të treguesit të dimensionimit**3.3.3.10 Vlerat e treguesit të dimensionimit****3.3.3.11 Vlera e nivelit të planit gjeohapësinor****3.3.3.12 Vlera e urdhëresës****3.3.3.13 Vlera e hapit të procesit të përgjithshëm****3.3.3.14 Vlera e natyrës së rregullores****3.3.3.15 Vlerat specifike të rregullores plotësuese****3.3.3.16 Vlera e rregullores plotësuese****3.4 Metadata****3.5 Kodi EPSG për KRGJSH-në****3.6 Cilësia e të dhënave**

3.6.1 Kompletimi – Autorizimi (*Completeness-commission*)



3.6.2 Kompletimi – Përfshirja (*Completeness–Omission*)

3.6.3 Përputhja ligjore – Përputhja konceptuale (*Logical consistency - Conceptual consistency*)

3.6.4 Saktësia e pozicionimit – Saktësia absolute apo e jashtme (*Positional accuracy - Absolute or external accuracy*)

3.6.5 Saktësia tematike – Korrektësia e klasifikimit (*Thematic accuracy - Classification correctness*)

3.6.6 Kërkesat minimale të cilësisë së të dhënave

4. ANEKSE

4.1 Aneksi A – Katalogu i tipologjisë

4.2 HILUCS – Sistemi i klasifikimit hierarkik nga INSPIRE

4.3 Kodlistat për nëntemen “Përdorimi ekzistues i tokës”

4.3.1 Vlerat HILUCS

4.4 Kodlistat për nëntemën “Planifikimi i përdorimit të tokës”

4.4.1 Vlerat e nivelit të planit gjeohapësinor

4.4.2 Vlerat e përgjithshme të hapit të procesit

4.4.3 Vlerat e natyrës së rregullores

4.4.4 Vlerat e rregullores plotësuese

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI-së, duke u mbështetur në direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mjedisit dhe Jetësisë të Prioriteteve (DPPMJP) dhe Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB). Data e publikimit të versionit nr. 1 është 15 nëntor 2017. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSIDI_2017_PT_v.1, ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2017 – Viti i krijimit

PT – Tema për të cilën është krijuar standardi “Përdorimi i tokës”, e cila i referohet temës “Land Use” të direktivës INSPIRE

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton specifikimet teknike për të dhënat gjeohapësinore të temës “Përdorimi i tokës”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/m, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI-së¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë midis tyre.

2.2 Si lexohet dokumenti

2.2.1 Struktura e dokumentit

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të kuptohet më lehtë.

3. Tema – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për secilën temë.

4. Aneks – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë shpjeguese në ndihmë të lexuesve.

- Përmbajtja e kapitullit të 3-të është strukturuar në 6 pjesë kryesore:

3.1 Përshkrimi i temës – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës dhe se si është e ndarë kjo temë.

3.2 Përshkrimi i nëntemës së parë – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës “Përdorimi ekzistues i tokës”, si dhe detajohen: Diagramet UML dhe katalogu i tipologjive.

3.3 Përshkrimi i nëntemës së dytë – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës “Planifikimi i përdorimit të tokës”, si dhe detajohen: Diagramet UML dhe Katalogu i tipologjive.

¹NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor.



3.4 Metadata – Këtu jepen specifikimet teknike për metadatat e temës përkatëse.

3.5 Sistemi Koordinativ Referencë – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë (KRGJSH)

3.6 Cilësia e të dhënave – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJISË

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesore të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, **ATRIBUTET** dhe marrëdhëniet janë të përfshira në “Katalogun e tipologjive” (*Feature Catalogue*). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të

familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit, Katalogu i tipologjive mund të jetë veçanërisht i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhënat e nevojshme për aplikacionet që ata përdorin.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të një shablloni, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: “FeatureType”, një element që mund të jetë real në terren apo një dukuri abstrakte. “DataType”, një element tabelor që shërben vetëm si tabelë attributesh për t’u lidhur me një element tjetër. “Enumeration”, “codeList”, listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton “listë vlerash ose ndryshe kodlistë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kodlistat”. “Union”, një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet që bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dyja grupeve të të dhënave hyrëse. “Imported”, të dhëna të specifikuar në tema të tjera të Direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden “Të dhënat e importuara”.
Gjeometria	Gjeometria e elementit, sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë ose poligon. “Abstrakt”, kur elementi nuk është element real në terren por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* – mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë; 1..* – mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera; 0..1 – mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme; 1 – duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë.
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet; Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet.
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve “Rol-shoqërimet” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.
ATRIBUTET	“Atribut” janë informacione të bashkëngjitura në format tabelor te tipologjitë gjeohapësinore.



Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit
-- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve.
-- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin. [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh., PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh., <i>ligjor</i>
-- Emri -- Emërtimi i vlerës
-- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve.
Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh., <i>joligjor</i>
-- Emri -- Emërtimi i vlerës
-- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementeve.

2.2.3 KARAKTERISTIKAT E VOIDABLE DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi *voidable* përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera *void*. Një vlerë *void* nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës *void* duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën VleraEArSyseSëPavlefshmërisë (VoidReasonValue), e cila përmban:

E panjohur (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull. Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

E papopulluar (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull. Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E pa populluar”.

Konfidenciale (Withheld)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

Shembull: Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi *voidable* nuk jep informacion nëse ekziston një karakteristikë në realitet. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh., nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në realitet, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh., nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4 MBULIMET – COVERAGES

Funksionet e mbulimit *Coverages* përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale, që zhvillohet në kohë dhe/ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohoro-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh., vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh., izolinet), rrjetet (p.sh., ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.





Figura 1. Shembuj të një rrjeti të korigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)



Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuar në SSH EN ISO 19123, 2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh., ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik, për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm (*Generic Conceptual Model*).

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *Rrjeti i Mbulimit i Korigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë (shih figurën 1, majtas).

- *Rrjeti i Mbulimit Referencë*: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim, që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.

2.2.5 NUMËRTIMET DHE KODLISTAT (ENUMERATION AND CODELIST)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistë, “vlera të tjera” përcakton llojin e përmbajtjes së kodlistës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- **“Jo”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vetëm vlera të specifikuar në këtë dokument.

- **“Të kufizuara”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

- **“Të hapura”** përfaqëson kodlistë që përmbajnë vlera të specifikuar në këtë dokument



dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

- **“po”** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera **jo** të përmbajtura në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin **“FillimiICiklitJetësor”** dhe **“PërfundimiICiklitJetësor”** për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi **“FillimiICiklitJetësor”** specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi **“PërfundimiICiklitJetësor”** specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin **“PërfundimiICiklitJetësor”** nuk shkaktojnë ndryshime në atributin **“FillimiICiklitJetësor”**.

Shënim i rëndësishëm

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh., featureType, dataType etj., nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të direktivës INSPIRE.

2.3 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit nr. 72/2012, neni 16, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës

Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG-u është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet evropiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI-së në Shqipëri janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – Në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhet të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilat do të implementojnë këtë direktivë.

- **Specifikimi i të dhënave** – Standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha **ATRIBUTET** e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 FUSHA E VEPRIMIT

Të gjitha autoritetet publike, kompani private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruara t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:




Figura 2. Proceset e ciklit jetësor

“Planifikimi” është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

“Vlerësimi” është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

“Procesimi” është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe modifikohen **ATRIBUTET** e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t’u publikuar.

“Shpërndarja” është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

“Zbulimi” është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jociësore në të dhënat e publikuara.

“Analiza” është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë

këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

“Përditësimi” është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

“Arkivimi” është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen, duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të paaksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

“Shkatërrimi” është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1 PËRDORIMI I TOKËS

3.1.1 PARATHËNIE

Përdorimi i tokës është përcaktuar si një territor i karakterizuar, sipas dimensionit funksional të planifikuar, aktual dhe të ardhshëm ose qëllimit social-ekonomik (p.sh.: rezidencial, industrial, tregtar, agrikultural, pyjor, rekreacional). Prandaj për menaxhimin e tokës duhet kushtuar kujdes monitorimit të mbulesës së tokës dhe ndryshimit të përdorimit të saj.



Qëllimi i temës “Përdorimi i tokës” nuk përfshin vetëm sipërfaqen aktuale të tokës, por mund dhe të tregojë se cilat përdorime janë direkt nën/mbi nivelin e tokës që kufizohen nga ndikimi i tyre fizik. Për shembull, një minierë mund të jetë tërësisht nën sipërfaqe, por mund të konsiderohet përdorim toke. Një tjetër shembull janë godinat e larta që përfshijnë dyqane në katin përdhes dhe banesat në kate të tjera. Në shumicën e rasteve aktivitetet njerëzore ndodhin në zona që përfshijnë “infrastrukturat” e nevojshme për realizimin e aktivitetit (p.sh., një zonë industriale që përfshin parkimet e makinave të nevojshme për stafin dhe klientët, kopshtet e nevojshme për mbarëvajtjet sociale, magazinat për mallrat, zyrat e administrimit – zyrat e menaxhimit). Trupat ujorë në brendësi të tokës, si dhe ujërat bregdetare konsiderohen brenda pjesës së bashkuar të tokës sapo ato të marrin pjesë në përdorimin ose funksionimin e asaj toke.

Përkufizimi i temës “Përdorimi i tokës” nga direktiva INSPIRE thekson dy pjesë të rëndësishme të kësaj teme:

Së pari, përdorimi i tokës është i përcaktuar si përdorim dhe funksion i një territori. Është përshkrimi i tokës në terma të qëllimit të saj social-ekonomik dhe ekologjik. Përdorimi i tokës është ndryshe nga Mbulesa e tokës, sepse bazohet te përshkrimi i sipërfaqes së tokës nga karakteristikat e saj biofizike. Megjithatë, Mbulesa e tokës dhe Përdorimi i tokës janë të lidhura me njëri-tjetrin dhe shpesh kombinohen në aplikime praktike. Grupet e të dhënave që kombinojnë këto dy tema shpesh theksojnë aspektet e përdorimit të saj në zonat me përdorim intensiv dhe aspektet e mbulimit po në këto zona. Një shembull i ndryshimit të përshkrimit të së njëjtës pjesë toke do të ishte një zonë agrikulturore me bar. Në Mbulesën e tokës do të përshkruhej si një kullotë (mbulimi i tokës është bar) ndërsa në Përdorimin e tokës do të klasifikohej si agrikulturë (përdorimi i saj do të ishte për kullotje).

Së dyti, vetë Përdorimi i tokës është i ndarë në dy lloje të ndryshme:

Përdorimi ekzistues i tokës, i cili përshkruan objektivisht përdorimin dhe funksionet e një territori, siç është në realitet. Përdorimi ekzistues i tokës do të modelohet sipas tri skemave të aplikimit:

- Përdorimi Ekzistues i Tokës ose PET (ELU)² përbëhet nga poligone;

- Përdorimi i Tokës i Thjeshtëzuar ose PTT (SLU), i cili përkon me përdorimin dhe funksionet e një grup-vendndodhjes të krahasuara në një zonë të dhënë;

- Rrjeti i Përdorimit të Tokës ose RPT (GLU), i cili përkon me një version të gjeoreferencuar të një grupi të dhënash të përdorimit ekzistues të tokës.

- **Planifikimi i Përdorimit të Tokës ose PPT (PLU)** përkon me planet gjeohapësinore, përcaktuar nga autoritetet e planifikimit gjeohapësinor, të cilat përshkruajnë përdorimin e mundshëm të tokës në të ardhmen. *Planifikimi i përdorimit të tokës* rregullohet nga dokumentet e planifikimit gjeohapësinor që përpunojnë në nivele të ndryshme të administrimit. Rregullorja e Përdorimit të tokës për një zonë gjeografike në përgjithësi përbëhet nga një orientim i përgjithshëm strategjik, një rregullim tekstual dhe një përfaqësim hartografik. Sfera e specifikimit të të dhënave INSPIRE të temës “Përdorimi i tokës” jep dimensionin e përpiktë gjeohapësinor të të gjitha elementeve nga i cili përbëhet një plan gjeohapësinor. Skema e aplikimit të “Planifikimit të përdorimit të tokës” bazohet kryesisht në *ElementZonimi*, që përshkruan zonimin e përcaktuar nga planifikuesit gjeohapësinorë dhe *Rregullorja plotësuese* që mundëson informimin mbi rregulloret që mbivendosen në zonim.

Specifikimi i të dhënave të temës “Përdorimi i tokës” mbështet dy sistemet e klasifikimit:

1. Sistemi HILUCS³ është sistemi i klasifikimit hierarkik të *Përdorimit të Tokës*. Ky është një sistem i ri klasifikimi që përfshin shumë nivele dhe do të zbatohet për përdorimin ekzistues dhe të planifikuar të tokës. Kjo do të mjaftojë që shtetet të hedhin në hartë sistemin e tyre specifik në nivelin e duhur të HILUCS-së. Ky sistem klasifikimi do të lejojë krahasimin e të dhënave të ndryshme nga shtetet të ndryshme. Ishte e nevojshme të përkufizohej HILUCS-ja, pasi asnjë sistem ekzistues i klasifikimit nuk plotësonte kërkesat për përshkrim të vazhdueshëm të përdorimit të tokës ekzistuese dhe të planifikuar në Evropë. Mundësia e dytë është shtimi i sistemit lokal të klasifikimit të

² Akronimi në anglisht.

³ HILUCS – Hierarchal INSPIRE Land Use Classification System – Sistemi i Klasifikimit Hierarkik INSPIRE.



shtetit anëtar ose në rastin e PPT-së, autoriteti që e nxjerr këtë plan. Megjithatë, ky sistem lokal duhet dokumentuar mirë, duke i lejuar përdoruesit të përdorin të dhënat dhe t'i krahasojnë ato me grupe të dhënash nga burime të tjera.

2. Sistemi i klasifikimit specifik që përdoret nga një shtet anëtar, i cili është opsional. Në rastin tonë mund të përmendim klasifikimin sipas nenit 15, të vendimit nr. 686, të Këshillit të Ministrave datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.

Tema “*Përdorimi i tokës*” ka lidhje me disa tema të tjera të nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, por është preferuar të mos përfshihet në marrëdhënie me këto tema në modelin konceptual, duke supozuar që funksionet gjeometrike të sistemeve të informacionit të përdoruesit do të mundësojnë llogaritjen e marrëdhënieve gjeohapësinore. Për shembull, përfshirja e një veçorie nga një temë tjetër në një karakteristikë të temës “*Përdorimi i tokës*” ose mbivendosja mes temave mund të rrillogaritet me mjetet e analizave gjeohapësinore. Te specifikimi i të dhënave të kësaj teme, përshkrimi i përdorimit të tokës nuk ofron përshkrim të objekteve gjeografike. Për shembull, një zonë në të cilën prodhohet energjia do të shikohet si një element unik në një grup të dhënash të temës “*Përdorimi i tokës*”, ku në temën “*Burimet energjetike*” mund të jepet një përshkrim më i detajuar i termocentralit, duke përfshirë diferencimin e pjesëve të tij.

Informacioni i “*Planifikimit të përdorimit të tokës*” shpesh është i mbivendosur në hartat kadastrale ose harta të tjera si ortoimazheri. Zgjedhja është bërë për të lejuar ofruesin e të dhënave të informojë për versionin e hartës bazë mbi të cilën është punuar plani gjeohapësinor pa implementuar marrëdhëniet direkte me temën përkatëse të përshkruar në “Standardet shtetërore të gjeoinformacionit”.

- Skema e aplikimit të temës “Përdorimi i tokës”

Ekzistojnë disa mënyra të ndryshme për të përshkruar “*Përdorimin e tokës*”. Kjo vjen pjesërisht

për shkak të gamës së gjerë të aspekteve të përdorimit funksional të tokës, pjesërisht për shkak të shpejtësisë së të dhënave të përdorimit të tokës dhe pjesërisht për shkak të ngatërresës mes “*Përdorimit të tokës*” dhe “*Mbulesës së tokës*” në grupet e të dhënave ekzistuese. Një skemë e zakonshme aplikimi nuk mund të mbështesë të gjitha përdorimet në të gjitha mjediset kompjuterike.


Prandaj, shumë mënyra, ndoshta jo të pajtueshme, të përshkrimit të “*Përdorimit të tokës*” do të vazhdojnë të ekzistojnë. Sisteme të ndryshme klasifikimi mund të përputhen dhe të krahasohen kur janë të dokumentuara mirë.

Për ndërtimin e skemës së aplikimit të temës “*Përdorimi i tokës*”, përkufizohen fillimisht aspektet e zakonshme për “*Përdorimin e tokës*”, duke përfshirë parimet HILUCS. Këto aspekte të zakonshme më pas zbatohen për përshkrimin e skemës së aplikimit të “*Përdorimit ekzistues të tokës*” (të tanishme ose të shkuar), skema e aplikimit të përdorimit të tokës së krahasuar, skema e aplikimit të “*Rrjetit të përdorimit të tokës*” dhe skema e aplikimit të “*Planifikimit të përdorimit të tokës*”.


Aspektet e zakonshme për “*Përdorimin e tokës*” përkojnë me një grup të dhënash të këtij përdorimi që mbulon një zonë dhe ofron një copëzim të asaj zone me poligone, të cilat janë ekskluzive në mënyrë reciproke ose me piksel (raster). Zona e mbuluar nga grupi i të dhënave të temës “*Përdorimi i tokës*” mund të ndryshojë nga zona e menaxhuar nga një autoritet, për shkak të shumë arsyeve që përfshijnë metodën e regjistrimit të të dhënave (p.sh., nga imazhet) ose konteksti ligjor. Aspektet e zakonshme janë po ashtu të vlefshme për një grup të dhënash të “*Përdorimit të tokës*”, që ofrojnë informacion mbi këtë përdorim bashkëngjitur një grupi të veçantë vendndodhjesh (kampione), siç tregohet në figurën 3. Këto poligone dhe vendndodhje përshkruhen nga një kategori e “*Përdorimit të tokës*”.




Paraqet Poligonet që mbivendosen në një ortoimazh



Paraqet pikselat që mbulojnë kufijtë administrativë dhe ujërat



Paraqet vendndodhjen e veçantë



Sistemi i klasifikimit paraqitet si legjendë

Figura 3. Duke treguar tri lloje të grupeve të të dhënave, që përmbajnë informacion mbi Përdorimin e tokës

3.1.2 TERMA DHE PËRKUFIZIME

“Administrim” kuptohen proceset e përcaktimit, të dokumentimit dhe të publikimit të të dhënave për pronësinë, për vlerën dhe përdorimin e tokës gjatë vënies në zbatim të politikave të menaxhimit të saj.

“Burime pyjore” është tërësia e elementeve natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut. Në ekonominë pyjore si burime natyrore përfshihen edhe toka, uji, bimësia jopyjore, e shumëllojshme, ato të natyrës jo të gjallë dhe gjallesat e egra.

“Dëmtim i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” është prishja e karakteristikave fiziko-kimike e

strukture të ekosistemit pyjor, ulja e prodhimtarisë biologjike dhe e shumëllojshmërisë së ekosistemeve përbërëse të fondit pyjor kombëtar.

“Ekosistem” është një kompleks dinamik komunitetesh: bimë, kafshë, mikroba dhe mjedisi jo i gjallë që ndërveprojnë si njësi funksionale.

“Kategori të resurseve” janë sipërfaqet e tokave bujqësore, të fondit pyjor, të fondit kullosor, si dhe sipërfaqet e brigjeve të lumenjve, të tokave të pafrytshme dhe të tokave urbane (trojeve).

“Kullotë” është sipërfaqe toke më e madhe se 0.5 ha, me bimësi barishtore natyrore të dendur, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër që



plotëson kërkesat për kullotje, së bashku me infrastrukturën përkatëse.

“Livadh” është sipërfaqe toke homogjene, e mbuluar me bar, i cili mund të kositet për t’u përdorur për blegtorinë ose që përdoret për kullotje e që nuk i përket fondit të tokës bujqësore.

“Menaxhim” kuptohen veprimtaritë e lidhura me përdorimin e tokës si një burim me vlera mjedisore dhe ekonomike.

“Mbrojtja e tokës” është tërësia e veprimeve dhe e masave që kryhen për mirëmbajtjen e tokës bujqësore, ruajtjen nga dëmtimi dhe rreziku i dëmtimit të çdo forme, si dhe pengimin e shmangien e faktorëve dëmtues të tokës të çdo natyre.

“Ngastër” është ndarja e sipërfaqes së ekonomisë pyjore në parcela, të cilat shërbejnë si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit të pyllit.

“Përdorimi ekzistues i tokës”, një përshkrim objektiv, me anë të të dhënave vektoriale, i përdorimit dhe funksioneve të një territori, siç ka qenë dhe është ende në mënyrë efektive në realitet.

“Rrjeti i përdorimit të tokës”, një përshkrim objektiv si një rrjet i rregullt, i ortorektifikuar (imazh) i përdorimit dhe funksioneve të një territori, siç ka qenë dhe është efektivisht në realitet.

“Planifikimi i përdorimit të tokës”, planet gjeohapësinore, të përcaktuara nga autoritetet e planifikimit gjeohapësinor përshkruajnë planifikimin e zhvillimeve të mundshme të tokës në të ardhmen.

“Përdorimi i tokës i thjeshtëzuar”, një përshkrim objektiv i përdorimit dhe i funksioneve të një territori (siç ka qenë dhe është efektivisht në realitet), siç është vëzhguar në vendndodhjen e krahasuar.

“Pjelloria e tokës bujqësore” është aftësia natyrore e tokës për sigurimin e njëkohshëm të ujit dhe të elementeve ushqyese për bimët dhe krijimi i kushteve të përshtatshme fizike dhe biokimike për to.

“Pronë pyjore” është një sipërfaqe e fondit pyjor, me madhësi të ndryshme, bashkë me infrastrukturën përkatëse, e cila është pronë publike që zotërohet nga pushteti qendror apo vendor ose pronë private.

“Pyll” është sipërfaqja e tokës më e madhe se 0.5 ha, e mbuluar me drurë më të lartë se 5 metra

dhe me shkallë mbulimi mbi 10 për qind ose me drurë të aftë për të arritur këto pragje.

“Rregulloret plotësuese”, tipologji (*shapefile*) gjeografike që ofrojnë informacion plotësues dhe/ose kufizim të përdorimit të tokës. Rregulloret plotësuese mund të jenë për arsye të planifikimit gjeohapësinor ose për shkak të nevojës për të formalizuar rregulloret e jashtme.

“Sistemi i HILUCS-së”, një sistem klasifikimi me shumë nivele për përdorimin e tokës nga INSPIRE.

“Shfrytëzim i pyjeve” janë ndërhyrja dhe trajtimet silvikulturore në jetën e pyllit, vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera, përpunimi dhe transporti i tyre në moshën e shfrytëzueshmërisë dhe kur është siguruar ripërtëritja natyrore.

“Toka” është shtresa e sipërme e kores së tokës që përfshin lëndën minerale, lëndën organike, pjesën e lëngshme, pjesën e gaztë, pjesën biotike dhe që përmbush funksionet e përcaktuara, si: funksionet natyrore, funksionet si arkiv i historisë së natyrës në të kaluarën dhe funksione të tjera në dobi të njeriut.

“Tokë bujqësore” është sipërfaqja e tokës që si e tillë figuron në regjistrat kadastralë të shtetit, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë.

“Tokë pyjore dhe pyll” janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30 për qind, sipërfaqet e zhveshura, çeltirat, vendet shkëmbore, tokat e gërryera e joprodhuese, ranishtat, rrugët pyjore, të pakadastruara në fondet e tjera të tokës bujqësore dhe të lidhura ekologjikisht e në mënyrë funksionale me fondin pyjor kombëtar, që, të gjitha së bashku, sigurojnë funksionet e pyllit.

“Të dhëna përshkruese” kuptohen libra ngastrash dhe regjistra të ndryshëm.

“Tokë e pafrytshme” kuptohet toka cilësisht e dobët që nuk përfshihet në zërat kadastralë: tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, kullota, livadhe e troje.

“Zonimi”, një ndarje ku përshkruhet përdorimi i tokës së planifikuar, duke i bërë të qarta rregullat e zhvillimit, si dhe kufizimet ligjore që aplikohen në këtë zonë.

Shënim. Zonimi është një përbërës i rëndësishëm i planifikimit të përdorimit të tokës. Normalisht ai përfshin rregullimin e të gjitha llojeve

të aktiviteteve, të cilat do të jenë të pranueshme në shumë pjesë të veçanta (siç janë hapësirat e hapura, rezidenciale, agrikulturore, tregtare ose industriale), densitetet në të cilat këto aktivitete mund të kryhen, sasinë e strukturave hapësinore që mund të zënë etj.

3.2 PËRSHKRIMI I NËNTEMËS “PËRDORIMI EKZISTUES I TOKËS”

3.2.1 PARATHËNIE

Grupet e të dhënave gjeohapësinore që ofrojnë informacion për “Përdorimin e tokës”, në kohën e vërtetimit, shpesh janë të organizuara si një pjesë e një zone të dhënë. Çdo element i poligonit është homogjen në lidhje me përdorimin funksional të tokës. Poligonet nuk mbivendosen mbi njëri-tjetrin. Zona e mbuluar nga të dhënat e “Përdorimit të tokës” mund të ndryshojë nga zona e menaxhuar nga një

autoritet. Për shembull, një qeverisje lokale mund të jetë përgjegjëse për grupin e të dhënave por zona e mbuluar nga këto të dhëna mund të jetë më e vogël se kufijtë administrativë të qeverisjes lokale ose mund të ketë hapësira bosh. Kjo mund të ndodhë, për shkak të shumë arsyeve, përfshirë metodën e tërheqjes së të dhënave (p.sh., nga imazheria) ose kontekstin ligjor. Grupet e të dhënave gjeohapësinore, që ofrojnë informacion për “Përdorimin e tokës”, në kohën e vërtetimit mund të jenë të organizuara si grupe të veçanta pikash, ku secila prej tyre vëzhgohen dhe shoqërohen me attribute që përshkruajnë “Përdorimin e tokës”. Kjo quhet *Përdorimi i tokës krahasues (PTK)*. Rrjeti i rregullt i përdorimit të tokës është një mënyrë paraqitje e Përdorimit ekzistues të tokës.



Figura 4. Shembull për grupin e të dhënave të përdorimit ekzistues të tokës




Figura 5. Shembull për përdorimin e tokës




Figura 6. Shembull për rrjetin e përdorimit të tokës

Çdo grup të dhënash i veçantë i “Përdorimit ekzistues të tokës” do të jetë “fotografi e çastit” në një moment të caktuar, vlera e shtuar e këtyre grupe të dhënash të veçanta me periudha të ndryshme kohore është fakti që “Përdorimi i tokës” ndryshon, me kalimin e kohës mund të monitorohet.

Shoqëruar me nomenklaturën, njësia minimale e interesit (quajtur njësia minimale e hartave ose njësia e vrojtimit) përkufizon nivelin e hollësive brenda grupit të të dhënave, d.m.th., madhësia minimale e poligonëve ose distanca minimale mes pikave të vrojtimit që gjenden në këto të dhëna. Ky informacion jepet brenda metadatës së shoqëruar me grupin e të dhënave.

3.2.2 SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMI UML PËR NËNTEMËN “PËRDORIMI EKZISTUES I TOKËS”

Skema e aplikimit të “Përdorimit ekzistues të tokës” korrespondon me një grup të dhënash që

përkufizon realitetin e “Përdorimit të tokës” në një kohë të caktuar.

Shfrytëzimi i një grupi të dhënash që përkufizon “Përdorimin ekzistues të tokës” mund të kërkojë informacion për të njëjtën pjesë toke në kohë të ndryshme. Skema e aplikimit nuk e implementon këtë kërkesë. Kjo do të thotë se “Përdorimi ekzistues i tokës” në të njëjtën zonë në dy kohë të ndryshme do të jepet si dy grupe të dhënash të ndryshme. Grupi i të dhënave të Përdorimit Ekzistues të Tokës përmban objektin e Përdorimit Ekzistues të Tokës që përkon me një zonë që ka një përdorim unik të përcaktuar të tokës. Një grup të dhënash të Përdorimit Ekzistues të Tokës mund të krijohet nga disa burime. Kështu, çdo Objekt i Përdorimit Ekzistues të Tokës mund të shoqërohet me kohën kur “Përdorimi i tokës” së dokumentuar përkon me **ATRIBUTET** e Përdorimit Ekzistues të Tokës.




Figura 7. Paraqitja UML e skemës së aplikimit të përdorimit ekzistues të tokës

Skema e aplikimit “Përdorimi ekzistues i tokës” mundëson dhënien e informacionit për përdorimet e tokës brenda një objekti të tillë. Objekti i Përdorimit Ekzistues të Tokës mund të shoqërohet, me:

- nga 1 në shumë PërdorimiITokësHilucs që përfaqëson “Përdorimin e tokës” për poligonin nga pikëpamja ekonomike. Kjo e bën të mundur caktimin e më shumë se një ekzistence Përdorimi i Tokës Hilucs kur nuk mund të menaxhohen nga Paraqitja Hilucs;

- nga 0 në shumë dataType PrezencaHilucs dhe PrezencaSpecifike për të mbledhur më shumë se një ekzistencë.

Përdorimi i Tokës Hiluc si identifikueshëm sipas rregullës së rëndësisë ose së përqindjes.

- nga 1 në shumë Përdorimi Specifik i Tokës nga sisteme klasifikimi të përcaktuara mirë dhe të qëndrueshme (kombëtare ose lokale);

- nga 0 në shumë dataType PrezencaSpecifike për të mbledhur më shumë se një ekzistencë PërdorimiSpecifikITokës e identifikueshme sipas rregullës së rëndësisë ose së përqindjes.

Sipas këtyre mundësive, identifikohen katër situata:

- Objekti i përdorimit të tokës shoqërohet me vetëm një përdorim toke, përdorimi mbizotërues i tokës:

Përdorimi i Tokës Hilucs do të ketë vetëm një vlerë (figura 8).



Figura 8. Shembull – Përdorimi i tokës Hilucs dhe përdorimi specifik i tokës

- Objekti i Përdorimit të tokës shoqërohet me disa përdorime të tokës pa njohuritë e rëndësisë relative: Përdorimi i tokës Hilucs do të ketë disa vlera. Ky fakt ndodh në rrethana të ndryshme, kur planifikimi mes kategorive kombëtare dhe HILUCS nuk është i plotë për disa detaje në kategori kombëtare (shembulli A – figura 9) ose kur informacioni jepet në nivele të ndryshme vertikale (shembulli B - figura 10) ose në kohë të ndryshme (shembulli C - figura 11).



Figura 9. Shembulli A




Figura 10. Shembulli B



Figura 11. Shembulli C

- Objekti i Përdorimit të tokës shoqërohet me disa përdorime të tokës me njohuritë e rëndësisë relative, por pa njohuritë e përpjesëtimit: Përdorimi i Tokës Hilucs do të ketë një vlerë duke qenë përdorim mbizotërues i tokës dhe Paraqitja Hilucs do të ofrojë listën e tokës por pa informuar për përqindje (figura 12).



Figura 12. Objekti i Përdorimit të Tokës me disa vlera Përdorimi i Tokës Hilucs me njohuritë e rëndësisë relative

- Objekti i Përdorimit të tokës shoqërohet me disa përdorime të tokës me njohuritë e rëndësisë dhe përpjesëtimit: Përdorimi i Tokës Hilucs do të ketë një vlerë, duke qenë përdorim mbizotërues i tokës dhe ParaqitjaHilucs do të ofrojë listën e tokës së bashku me përqindjet (figura 13).



Figura 13. Objekti i Përdorimit të tokës me disa vlera të Përdorimi i tokës Hilucs me njohuri të rëndësisë dhe proporcionit relativ

Mundësia e ofrimit të disa përdorimeve nuk tregon vendndodhjen e çdo “Përdorimi të tokës”, por do të mundësojë dhënien e rëndësisë së tyre relative dhe ofrimin e përqindjeve respektive, për të bërë të mundur llogaritjet e sipërfaqes së çdo Përdorimi toke brenda një zone por vetëm një lloj prezence (rregullat e rëndësisë dhe përqindjes) mund të jepet njëkohësisht.

Përdorimi Specifik i Tokës ka gjithmonë një vlerë konstante 1 dhe mund të ofrohet vetëm një vlerë specifike.

Megjithatë Prezenca Specifike ka ngjashmëri me Prezenca Hilucs.

Të dyja **ATRIBUTET** “Përqindje” jepen për të dy Prezenca Hilucs dhe Prezenca Specifike, sepse nuk pritet që përdoruesit të hartojnë nga e para Objektin e Përdorimit të Tokës. Këto janë voidable, sepse mund të ekzistojë një situatë reale ku shumë përdorime ekzistojnë në një zonë të dhënë pa ditur rëndësinë e tyre relative.

Shtirja e grupeve të të dhënave Përdorimi Ekzistues i Tokës është e përkufizuar si kufiri i unionit të të gjithë poligoneve (Objekti i Përdorimit të Tokës), që janë anëtarë të grupeve të të dhënave Përdorimi Ekzistues i Tokës (figura 14).




Figura 14 . Vijat me pika përkufizojnë shtrirjen e një grupi të dhënash të Përdorimit Ekzistues të Tokës

- Skema e aplikimit të Rrjetit të Përdorimit të Tokës

Skema e *Rrjetit të përdorimit të tokës* përkon me një grup të dhënash, që përshkruan përdorimin e tokës me piksel, çdo piksel shoqërohet me 1 (një) *Prezenca Hilucs* ose 1 (një) *Prezenca Specifike* (figura 15).




Figura 15. Paraqitja UML e skemës së aplikimit të Rrjetit të Përdorimit të Tokës

-Përkufizimet e mëposhtme eksportohen nga dokumenti i lartpërmendur:

- aneksi III, temat “Burimet energjetike” dhe “Burimet minerare”.

4.3 KODLISTAT PËR NËNTEMEN “PËRDORIMI EKZISTUES I TOKËS”

4.3.1 VLERAT HILUCS

-- Emri --

Vlera HILUCS

-- Përkufizimi --

Lista e kategorive të përdorimit të tokës së përdorshme në *Përdorimin e tokës*, i dakortësuar nga niveli evropian.

-- Përkufizimi --

Kjo listë është plotësuar me kategoritë e përdorimit të tokës nga sistemi i klasifikimit hierarkik të përdorimit të tokës INSPIRE (HILUCS). Elementet e listës duhet të jetë të aplikueshme për përdorimin ekzistues të tokës dhe atë të planifikuar.

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë janë vetëm vlerat e specifikuara më poshtë në tabelë.

Kodlistë
1_ -- Emri -- Prodhimi parësor -- Përkufizimi -- Sipërfaqe ku prodhimi i mallrave është direkt i bazuar në burimet natyrore lokale. Sektori parësor, primar transformon burimet natyrore në prodhime primare. Shumica e produkteve nga ky sektor janë materiale të papërpunuara për industri të tjera si (p.sh., industria ushqimore, e metaleve, e përpunimit të drurit) ose konsumohen direkt nga përdoruesit përfundimtarë. Nënsektorët kryesorë të prodhimit primar janë bujqësia, blegtoaria, agrobiznesi, peshkimi, pylltaria, minierat, aktivitetet e nxjerrjes së inerteve. Sipërfaqet ku industritë prodhuese grumbullojnë, prodhojnë, purifikojnë ose përpunojnë produktet primare pranë prodhuesve parësorë, duhet të përfshihen, në veçanti nëse lënda e parë është e papërshtatshme për shitje ose e vështirë për t'u transportuar në distanca të gjata. 1_1 -- Emri -- Bujqësi -- Përkufizimi -- Prodhimi i kulturave (bimëve, kërpudhave etj.) dhe i produkteve shtazore për ushqim, për shitje, për konsum personal ose për qëllime industriale. Përfshihen bimët për biokarburantet dhe kultivimin e të mbjellave në fusha të hapura dhe në serra. Gjithashtu, në këtë klasë përfshihen tokat e pambjella për arsye rigjenerimi. Këtu përfshihet përgatitja e produkteve për tregjet primare, ndërtimi i terrenit (p.sh., terracimi i tokës bujqësore, kullimi, përgatitja e fushave të orizit etj.), si dhe kujdesi dhe mirëmbajtja e peizazhit. --Varësia-- ProdhimParësor



Kodlistë
1_1_1 -- Emri -- Prodhimi bujqësor tregtar -- Përkufizimi -- Toka e kultivuar, kulturat e përhershme dhe kullotat në përdorim bujqësor (kullota të mbjella dhe natyrore). Produktet mund të përdoren si ushqim për njerëzit ose kafshët, si dhe për prodhimin e bioenergjisë. --Varësia-- <i>Bujqësi</i>
1_1_2 -- Emri -- Infrastruktura bujqësore -- Përkufizimi -- Strukturat e fermave, infrastruktura e blegtorisë (stallat dhe infrastruktura përpunuese e lidhur me fermat), ruajtja e plehut organik dhe infrastruktura të tjera bujqësore (p.sh., ndërtesat e lidhura me trajtimin dhe përpunimin e bimëve në ferma). --Varësia-- <i>Bujqësi</i>
1_1_3 -- Emri -- Prodhimi bujqësor për konsum vetjak -- Përkufizimi -- Kultivimi i bimëve ose mbarështimi i kafshëve për konsum vetjak (kopshte private, strehë për kafshët etj.). --Varësia-- <i>Bujqësi</i>
1_2 -- Emri -- Pyjet -- Përkufizimi -- Prodhimi i drurëve pyjorë dhe i produkteve të tjera primare me bazë druri. Përveç prodhimit të lëndës drusore, aktivitetet pyjore rezultojnë në prodhime që i nënshtrohen pak përpunimit, si: dru zjarri, qymyr druri dhe drurë të papërpunuar (p.sh., trarë, tallash etj.). Gjithashtu përfshihen edhe rritja e drurëve pyjorë, zonat e magazinimit dhe të transportit të lidhura me prerjet e drurëve dhe bimët drusore për biokarburantet. Këto aktivitete mund të kryhen në pyje natyrore ose të mbjella. --Varësia-- <i>ProdhimParësor</i>
1_2_1 -- Emri -- Pyllëzim i bazuar në rritje afatshkurtër -- Përkufizimi -- Zonat pyjore ku periudha e rritjes të një brezi peme është 50 vjet ose më pak, pas së cilës pylli rigjenerohet natyrshëm ose artificialisht me mbjellje fidanësh ose farash. Plantacionet e drurit (prodhimi i lëndës drusore) dhe druri i përdorur për prodhimin e biomasës i përkasin kësaj klase. --Varësia-- <i>Pyje</i>
1_2_2 -- Emri -- Pyllëzim i bazuar në rritje, afatmesëm ose afatgjatë -- Përkufizimi -- Zonat pyjore, ku periudha e rritjes të një brezi peme është mbi 50 vjet, pas të cilit pylli rigjenerohet natyrshëm ose artificialisht me mbjellje fidanësh ose farash. --Varësia-- <i>Pyje</i>
1_2_3 -- Emri -- Pyllëzimi i bazuar në mbulim të vazhdueshëm -- Përkufizimi -- Zonat pyjore ku menaxhimi dhe rigjenerimi i pyjeve bazohet në rritjen e vazhdueshme të drurëve.



Kodlistë
--Varësia-- <i>Pyje</i> 1_3 -- Emri -- Miniera dhe gurore -- Përkufizimi -- Miniera dhe gurore në formën e nxjerrjes së mineraleve dhe materialeve që ndodhen natyrshëm si lëndë të ngurta (qymyri, xeherore, zhavorr, rërë, kripë), lëngje (naftë), gaz (gaz natyror) ose biomasë (torfe). Nxjerrja mund të arrihet me metoda të ndryshëm, si nxjerrja nga minierat sipërfaqësore, nëntokësore etj. --Varësia-- <i>ProdhimParësor</i>
1_3_1 -- Emri -- Miniera e materialeve prodhuese të energjisë -- Përkufizimi -- Minierat dhe nxjerrja e qymyrgurit, linjtit, torfe, naftës, gazit natyror, uraniumit dhe toriumit. --Varësia-- <i>MinieraDheGurore</i>
1_3_2 -- Emri -- Minierat e mineraleve metalike -- Përkufizimi -- Minierat e hekurit dhe të mineraleve të tjera me ngjyra (përveç uraniumit dhe toriumit). --Varësia-- <i>MinieraDheGurore</i>
1_3_3 -- Emri -- Miniera dhe gurore të tjera -- Përkufizimi -- Nxjerrja e gurit, rërës, argjilave, kimikateve, mineraleve të plehrave, prodhimit të kripës etj. --Varësia-- <i>MinieraDheGurore</i>
1_4 -- Emri -- Agrikultura dhe peshkimi -- Përkufizimi -- Peshkimi profesional dhe agrikultura --Varësia-- <i>ProdhimParësor</i>
1_4_1 -- Emri -- Agrikultura -- Përkufizimi -- Vaska peshku dhe rezervate të menaxhuara. --Varësia-- <i>AgrikulturaDhePeshkimi</i>
1_4_2 -- Emri -- Peshkimi profesional -- Përkufizimi -- Ujëra të përdorura për peshkim profesional. --Varësia-- <i>AgrikulturaDhePeshkimi</i>
1_5



Kodlistë
-- Emri -- Prodhime të tjera primare -- Përkufizimi -- Gjuetia profesionale, grumbullimi i produkteve të shkurreve të egra, mbarështimi i kafshëve migratore dhe çdo prodhim tjetër primar, që nuk përfshihen në vlerat 1_1_Bujqësi, 1_2_Pyje, 1_3_MinieraDheGurore, 1_4_AkuakulturëDhePeshkim ose ndonjë nga vlerat e tyre më të ngushta. --Varësia-- <i>ProdhimParësor</i>
1_5_1 -- Emri -- Gjuetia -- Përkufizimi -- Gjuetia profesionale. Zonat mund të jenë të rrethuara ose të hapura. --Varësia-- <i>ProdhimeTëTjeraPrimare</i>
1_5_2 -- Emri -- Menaxhimi i kafshëve migratore -- Përkufizimi -- Përkujdesja dhe ushqimi i kafshëve migratore, si renë (dreri verior) dhe dreri. --Varësia-- <i>ProdhimeTëTjeraPrimare</i>
1_5_3 -- Emri -- Mbledhja e produkteve natyrore -- Përkufizimi -- Mbledhja e produkteve natyrore të shkurreve të pakultivuara, si: manaferrat, myshqet, likenet etj., për qëllime komerciale. --Varësia-- <i>ProdhimeTëTjeraPrimare</i>
2_ -- Emri -- Prodhimi dytësor -- Përkufizimi -- Aktivitetet industriale dhe prodhuese të cilat marrin produktet e sektorit parësor dhe prodhojnë mallra të përfunduara dhe produkte të ndërmjetme për biznese të tjera. Këtu, gjithashtu, përfshihen zonat e magazinimit dhe të transportit të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet prodhuese. Degët e industrive të mbuluara nga kjo klasë janë përpunimi i: ushqimeve, tekstilit, lëkurës, drurit dhe produkteve drusore, lëndës drusore, letrës, botimit, shtypjes, naftës dhe lëndëve të tjera djegëse, kimikateve, produkteve kimike, fibrave të prodhuara nga njeriu, produkteve të gomës dhe plastikës, produkteve minerale jometalike, metaleve bazë dhe produkteve metalike, prodhimeve metalike të fabrikuara, makinerive dhe pajisjeve, pajisjeve elektrike dhe optike, pajisjeve të transportit dhe mobiliet. --Varësia-- <i>ProdhimDytësor</i>
2_1 -- Emri -- Industria e papërpunuar -- Përkufizimi -- Aktivitetet industriale që transformojnë produktet e sektorit parësor në prodhime të papërpunuara. --Varësia-- <i>ProdhimDytësor</i>
2_1_1 -- Emri -- Prodhimi i produkteve tekstile -- Përkufizimi --



Kodlistë
Përgatitja dhe tjerja e fibrave tekstile, fijeve për qepje, gërshetimi i tekstilit, ngjyrosja dhe veshja e lëkurës.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_2 -- Emri -- Prodhimi i drurit dhe i produkteve me bazë druri -- Përkufizimi -- Sharrimi dhe planifikimi i drurit, prodhimi i fletëve për rimeso, kompensatat, fletët e fibrës, zdrukthëtari dhe mobilieri, tape, kashtë dhe produkteve përthurje.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_3 -- Emri -- Prodhimi i letrës dhe produkteve të saj -- Përkufizimi -- Prodhimi i pulpës, letrës, kartonit, letrave higjienike, letrave të murit.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_4 -- Emri -- Prodhimin e produkteve të rafinuara të naftës koks dhe karburantit bërthamor -- Përkufizimi -- Prodhimi i koksit, naftës së rafinuar dhe përpunimit të karburantit bërthamor.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_5 -- Emri -- Prodhimi i kimikateve, produkteve kimike, fibrave të bëra nga njeriu -- Përkufizimi -- Prodhimi i kimikateve bazë, agrokimikateve, bojërave, farmaceutikeve, sapunëve, detergjenteve, ngjitësve, produkteve të tjera kimike dhe fibrave të bëra nga njeriu.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_6 -- Emri -- Prodhimi i metaleve bazë dhe metaleve të fabrikuar -- Përkufizimi -- Prodhimi, përpunimi dhe derdhja e hekurit, çelikut dhe metaleve të çmuar dhe me ngjyra. Gjithashtu përfshihet edhe prodhimi i produkteve metalike.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_7 -- Emri -- Prodhimi i produkteve minerale jometalike -- Përkufizimi -- Prodhimi i qelqit, tullave, qeramikës, betonit, çimentos, gëlqeres, llaçit, prerjes dhe formimit të gurit dhe produkteve të tjera jometalike minerale.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_1_8 -- Emri -- Prodhimi i produkteve plastike prej gome -- Përkufizimi -- Prodhimi i gomave, tubave, paketimeve plastike dhe produkteve të tjera të gomës dhe të plastikës.
--Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>



Kodlistë
2_1_9 -- Emri -- Prodhimi i materialeve të tjera të papërpunuara -- Përkufizimi -- Prodhimi i lëndëve të para që nuk përfshihen në ndonjë nga vlerat e klasës 2_1_IndustriaPapërpunuar. --Varësia-- <i>IndustriaEPapërpunuar</i>
2_2 -- Emri -- Industrinë e prodhimit të rëndë -- Përkufizimi -- Aktivitete që transformojnë produktet e papërpunuara në produkte të prodhimit të rëndë. --Varësia-- <i>ProdhimDytësor</i>
2_2_1 -- Emri -- Prodhimi i makinerive -- Përkufizimi -- Prodhimi i makinerive në shërbim të bujqësisë dhe pylltarisë (me përjashtim të avionëve dhe automjeteve), prodhimit të armëve, municioneve dhe pajisjeve shtëpiake. --Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëRëndë</i>
2_2_2 -- Emri -- Prodhimi i automjeteve dhe i pajisjeve të transportit -- Përkufizimi -- Prodhimi i mjeteve motorike, avionëve, anijeve, varkave, pajisjeve hekurudhore dhe tramvajeve, motoçikletave, biçikletave dhe pajisjeve të tjera të transportit. --Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëRëndë</i>
2_2_3 -- Emri -- Prodhimi i produkteve të tjera përfundimtare të rënda -- Përkufizimi -- Prodhimi i produkteve të tjera përfundimtare të rënda, të cilat nuk përfshihen në ndonjë nga vlerat e klasës 2_2_IndustriaProdhimitTëRëndë. --Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëRëndë</i>
2_3 -- Emri -- Industria e prodhimit të lehtë -- Përkufizimi -- Aktivitete që transformojnë prodhimet e papërpunuara në prodhime të lehta. --Varësia-- <i>ProdhimDytësor</i>
2_3_1 -- Emri -- Prodhimi i ushqimit, pijeve dhe produkteve të duhanit -- Përkufizimi -- Prodhimi i mishit, peshkut, frutave dhe perimeve, vajrave dhe yndyrave ose nënprodukteve, produkteve të qumështit, bluarja e grurit dhe e produkteve të niseshtesë, ushqimeve të përgatitura për kafshë, produkteve të tjera ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit. --Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëLehtë</i>
2_3_2 -- Emri -- Prodhimi i robave dhe lëkurës



Kodlistë
-- Përkufizimi -- Prodhimi i veshmbathjeve, veshjeve prej lëkure, veshjeve, aksesoreve, ngjyrosjes së leshit dhe prodhimit të produkteve të leshit, valixheve, çantave, shalave dhe këpucëve.
--Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëLehtë</i>
2_3_3 -- Emri -- Botimi dhe shtypja -- Përkufizimi -- Botimi dhe shtypja e librave, gazetave, revistave, si dhe botimi dhe riprodhimi i regjistrimeve të zërit.
--Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëLehtë</i>
2_3_4 -- Emri -- Prodhimi i pajisjeve elektrike dhe optike -- Përkufizimi -- Prodhimi i makinerive të zyrave, kompjuterëve, motorëve, gjeneratorëve, shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike, telave dhe kablllove, akumulatorëve, baterive, llambave, radiove, televizorëve, telefonave, valvulave elektronike dhe tubave, aparaturave mjekësore, instrumenteve optike, orëve dhe pajisjeve të tjera elektrike dhe optike.
--Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëLehtë</i>
2_3_5 -- Emri -- Prodhimi i produkteve tjera të lehta -- Përkufizimi -- Prodhimi i mobileve, stolive, instrumente muzikore, mallra sportive, lojërave, lodrave dhe produkteve të tjera të ndryshme.
--Varësia-- <i>IndustriaProdhimitTëLehtë</i>
2_4 -- Emri -- Prodhimi i energjisë -- Përkufizimi -- Prodhimi i energjisë.
--Varësia-- <i>ProdhimDytësor</i>
2_4_1 -- Emri -- Prodhim energjie me bazë bërthamore -- Përkufizimi -- Termocentrale bërthamore.
--Varësia-- <i>ProdhimEnergjie</i>
2_4_2 -- Emri -- Prodhim energjie me bazë lëndë djegëse fosile -- Përkufizimi -- Termocentralet që përdorin lëndët djegëse fosile (qymyrguri, vaj, gaz natyror, torfe dhe lëndë djegëse të tjera fosile).
--Varësia-- <i>ProdhimEnergjie</i>
2_4_3 -- Emri -- Prodhim energjie me bazë biomase -- Përkufizimi -- Termocentralet e djegies, duke përdorur lëndë djegëse me bazë biomase (dru dhe lëndë djegëse të tjera të ngurta apo të lëngshme, biogaz dhe biokarburantet e tjera).



Kodlistë
--Varësia-- <i>ProdhimEnergjie</i>
2_4_4 -- Emri -- Prodhim energjie të rinovueshme -- Përkufizimi -- Energjia hidrike, diellore, eolike, termike (aero, gjeo dhe hidro), nga baticat, valët etj. dhe energji të tjera të rinovueshme (përveç energjisë së biomasës, e cila mbulohet nga vlerat e 2_4_3_3_ProdhimEnergjieMeBazëBiomase).
--Varësia-- <i>ProdhimEnergjie</i>
2_5 -- Emri -- Industri të tjera -- Përkufizimi -- Prodhimi i produkteve të tjera industriale, që nuk përfshihen në ndonjë nga vlerat në klasën 2_ProdhimDytësor.
--Varësia-- <i>ProdhimDytësor</i>
3_ -- Emri -- Prodhim terciar -- Përkufizimi -- Shërbimet që janë produkte për biznese dhe konsumatorë të tjerë, si shërbimet private, ashtu edhe ato publike. Përfshihet tërësia e shitjeve dhe tregtia me pakicë, shërbimet e riparimit, hotelet dhe restorantet, shërbimet financiare, pasuritë e paluajtshme, shërbimet e biznesit, shërbimet e qirasë, administrata publike, mbrojtja dhe siguria shoqërore, arsimi, shëndetësia dhe punët sociale, si edhe shërbimet e tjera komunitare, sociale dhe personale.
3_1 -- Emri -- Shërbime tregtare -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve tregtare --Varësia-- <i>ProdhimTerciar</i>
3_1_1 -- Emri -- Tregtia me shumicë e pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe i mallrave personale dhe shtëpiake -- Përkufizimi -- Shitja me shumicë dhe pakicë e automjeteve, lëndëve djegëse, lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, mineraleve, metaleve, kimikateve, drurit, makinerive, anijeve, mobilieve, mallrave shtëpiake, tekstileve, ushqimit, pijeve, produkteve të duhanit, produkteve farmaceutike, mallrave të dorës së dytë, produkte të tjera, mbeturina dhe mbetjet. Kjo klasë, gjithashtu, përfshin riparimin e automjeteve, mallrave personale dhe shtëpiake. --Varësia-- <i>ShërbimeTregtare</i>
3_1_2 -- Emri -- Shërbimet e pasurive të paluajtshme -- Përkufizimi -- Sigurimi i pasurive të paluajtshme dhe shërbimet e marrjes me qira. --Varësia-- <i>ShërbimeTregtare</i>
3_1_3 -- Emri -- Strehim dhe shërbime ushqimore -- Përkufizimi -- Shërbimet hoteliere, fshatrat turistike, kampingjet, restorantet dhe baret. --Varësia-- <i>ShërbimeTregtare</i>
3_1_4 -- Emri --

**Kodlistë**

Shërbime të tjera tregtie

-- Përkufizimi --

Shërbime të tjera tregtare, që nuk përfshihen në ndonjë nga vlerat e 3_1_ShërbimeTregtare, siç janë shërbimet e përkujdesjes, bukurisë dhe mirëqenies.

--Varësia--*ShërbimeTregtare*

3_2

-- Emri --

Shërbime profesionale informative dhe financiare

-- Përkufizimi --

Ofrimi i shërbimeve financiare, profesionale ose informative.

--Varësia--*ProdhimTerciar*

3_2_1

-- Emri --

Shërbime financiare dhe të sigurimit

-- Përkufizimi --

Sipërfaqet e përdorura për ofrimin e shërbimeve bankare, të kreditit, sigurimeve dhe shërbimeve të tjera financiare.

--Varësia--*ShërbimeProfesionaleInformativeDheFinanciare*

3_2_2

-- Emri --

Shërbimet profesionale teknike dhe shkencore

-- Përkufizimi --

Konsultime IT, përpunim i të dhënave, hulumtim dhe zhvillim, konsulenca ligjore, shërbime kontabiliteti, menaxhim i biznesit, shërbime arkitekture, inxhinierike, reklamim, testim, hetim, konsultime dhe shërbime të tjera profesionale.

--Varësia--*ShërbimeProfesionaleInformativeDheFinanciare*

3_2_3

-- Emri --

1. Shërbime informimi dhe komunikimi

-- Përkufizimi --

Botime, inçizime zanore, programe televizive, filma, transmetim radio, postë dhe telekomunikacion, shërbime kompjuterike dhe të përpunimit të të dhënave.

--Varësia--*ShërbimeProfesionaleInformativeDheFinanciare*

3_2_4

-- Emri --

Shërbimet administrative dhe mbështetëse

-- Përkufizimi --

Agjenci udhëtimi, marrje me qira, pastrim, agjenci sigurimesh dhe shërbime të tjera administrative dhe mbështetëse.

--Varësia--*ShërbimeProfesionaleInformativeDheFinanciare*

3_2_5

-- Emri --

Shërbime të tjera profesionale informative dhe financiare

-- Përkufizimi --

Shërbimet e tjera profesionale financiare dhe informative që nuk përfshihen në ndonjë nga vlerat e 3_2_ShërbimeProfesionaleInformativeDheFinanciare.

--Varësia--*ShërbimeProfesionaleInformativeDheFinanciare*



Kodlistë
3_3 -- Emri -- Shërbime komunitare -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve për komunitetin. --Varësia-- <i>ProdhimTerciar</i>
3_3_1 -- Emri -- Shërbime të administratës publike për mbrojtjen dhe sigurimet shoqërore -- Përkufizimi -- 2. Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme administrative, të mbrojtjes, drejtësisë, sigurisë publike, zjarrit dhe shërbimeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore. --Varësia-- <i>ShërbimeKomunitare</i>
3_3_2 -- Emri -- Shërbime arsimore -- Përkufizimi -- 3. Ofrimi i shërbimeve arsimore për ciklin parashkollor, të ulët, të mesëm, të lartë dhe shërbimeve të tjera arsimore. --Varësia-- <i>ShërbimeKomunitare</i>
3_3_3 -- Emri -- Shërbime shëndetësore dhe sociale -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për njerëzit dhe kafshët, si dhe shërbimeve sociale. --Varësia-- <i>ShërbimeKomunitare</i>
3_3_4 -- Emri -- Shërbime fetare -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve fetare --Varësia-- <i>ShërbimeKomunitare</i>
3_3_5 -- Emri -- 4. Shërbime të tjera për komunitetin -- Përkufizimi -- Shërbime të tjera për komunitetin si, p.sh., varrezat. --Varësia-- <i>ShërbimeKomunitare</i>
3_4 -- Emri -- Argëtim kulturor dhe shërbime rekreative -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve kulturore, zbavitëse ose rekreative. --Varësia-- <i>ProdhimTerciar</i>
3_4_1 -- Emri --



Kodlistë
Shërbimet kulturore -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve artistike, bibliotekave, muzeumeve, kopshteve botanike e zoologjike, vendbanimeve historike dhe shërbimeve të tjera kulturore. -- Varësia -- <i>ArgëtimKulturorDheShërbimeRekreative</i>
3_4_2 -- Emri -- Shërbimet argëtuese -- Përkufizimi -- Parqe zbavitës, parqe tematike, kazino, pika bastesh dhe lojëra fati, si dhe shërbime të tjera argëtuese. -- Varësia -- <i>ArgëtimKulturorDheShërbimeRekreative</i>
3_4_3 -- Emri -- Infrastruktura sportive -- Përkufizimi -- Infrastrukturë sportiv, si: stadione, pallate sporti, pishina, palestra, kompleks skish, fusha golfi etj. -- Varësia -- <i>ArgëtimKulturorDheShërbimeRekreative</i>
3_4_4 -- Emri -- Hapësira rekreative të hapura -- Përkufizimi -- Hapësira rekreative të hapura, p.sh.: parqet urbane, këndet e lojërave, parqet kombëtare dhe zonat natyrore të përdorura për qëllime rekreative (p.sh.: pyjet, malet, fushat bujqësore, pellgjet, liqenet, lumenjtë). -- Varësia -- <i>ArgëtimKulturorDheShërbimeRekreative</i>
3_4_5 -- Emri -- Shërbime të tjera rekreative -- Përkufizimi -- Shërbime të tjera rekreative që nuk përfshihen në asnjë nga vlerat e 3_4_4 <i>ArgëtimKulturorDheShërbimeRekreative</i> -- Varësia -- <i>ArgëtimKulturorDheShërbimeRekreative</i>
3_5 -- Emri -- Shërbime të tjera -- Përkufizimi -- Ofrimi i shërbimeve të tjera që nuk përfshihen në asnjë nga vlerat e klasës 3_5 <i>ProdhimTerciar</i> . -- Varësia -- <i>ProdhimTerciar</i>
4_ -- Emri -- Rrjeti i transportit logjistik dhe shërbime komunale -- Përkufizimi -- Infrastruktura e rrjeteve bazike. Të gjithë sektorët e tjerë përdorin infrastrukturën dhe rrjetet për të prodhuar mallra dhe shërbime, gjithashtu edhe zonat e banuara. Këtu përfshihet përdorimi i tokës për furnizimin me ujë, mbledhjen, trajtimin dhe riciklimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave, transportin, rrjetet, grumbullimin dhe komunikimin.
4_1 -- Emri -- Rrjeti i transportit -- Përkufizimi -- Infrastruktura që lidhet me transportin
4_1_1 -- Emri -- Transporti rrugor



Kodlistë
-- Përkufizimi -- Sipërfaqet e përdorura për transportin rrugor, p.sh., rrugët, zonat e parkimit, stacionet e shërbimit. --Varësia-- <i>RrjetiTransportit</i>
4_1_2 -- Emri -- Transport hekurudhor -- Përkufizimi -- Sipërfaqe e përdorur për transportin hekurudhor, p.sh., binarët, stacionet hekurudhore dhe hapësirat ndihmëse etj. --Varësia-- <i>RrjetiTransportit</i>
4_1_3 -- Emri -- Transport ajror -- Përkufizimi -- Sipërfaqe e përdorur për transportin ajror, p.sh. aeroportet dhe shërbimet përkatëse. --Varësia-- <i>RrjetiTransportit</i>
4_1_4 -- Emri -- Transport ujor -- Përkufizimi -- Sipërfaqe e përdorur për transportin ujor, p.sh.: portet, lumenjtë, molet dhe shërbimet që lidhen me to. --Varësia-- <i>RrjetiTransportit</i>
4_1_5 -- Emri -- Rrjet tjetër transportues -- Përkufizimi -- 5. Sipërfaqe e përdorur për transporte të tjera që nuk përfshihen në asnjë nga vlerat e 4_1_RrjetiTransportit. --Varësia-- <i>RrjetiTransportit</i>
4_2 -- Emri -- Shërbime logjistike dhe të magazinimit -- Përkufizimi -- Sipërfaqe të veçanta të përdorura për shërbime logjistike dhe magazinimi (të lidhura jo direkt me industrinë). --Varësia-- <i>RrjetiTransportitLogjistikDheShërbimeKomunale</i>
4_3 -- Emri -- Shërbime komunale -- Përkufizimi -- Infrastrukturë në lidhje me shërbimet. --Varësia-- <i>RrjetiTransportitLogjistikDheShërbimeKomunale</i>
4_3_1 -- Emri -- Shërbime të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit dhe energjisë termike -- Përkufizimi -- Sipërfaqe e përdorur për shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit dhe energjisë termike. Kjo klasë përfshin tubacionet e përdorura për transportin e naftës dhe gazit. --Varësia--



Kodlistë
<i>ShërbimeKomunale</i> 4_3_2 -- Emri -- Infrastrukturë ujësjellës kanalizime -- Përkufizimi -- Sipërfaqe e përdorur për nxjerrjen, grumbullimin, pastrimin dhe shpërndarjen e ujit, si dhe mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza (duke përfshirë tubacionet). --Varësia-- <i>ShërbimeKomunale</i>
4_3_3 -- Emri -- Menaxhimi i mbetjeve -- Përkufizimi -- Sipërfaqe e përdorur për grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve (landfill, incenerator, kompostim, trajtimi i mbeturinave të rrezikshme dhe riciklimi i tyre). -- Burimi -- <i>ShërbimeKomunale</i>
4_3_4 -- Emri -- Shërbime të tjera komunale -- Përkufizimi -- 6. Sipërfaqe e përdorur për shërbime të tjera që nuk përfshihen në asnjë nga vlerat e 4_3_ShërbimeKomunale. -- Burimi -- <i>ShërbimeKomunale</i>
5_ -- Emri -- Përdorim banimi -- Përkufizimi -- Sipërfaqe të përdorura kryesisht për banim. Format e strehimit ndryshojnë ndjeshëm në zonat e banimit. Këto sipërfaqe përfshijnë banim njëfamiljar, banim shumëfamiljar ose shtëpitë e lëvizshme në qytete, qyteza dhe zona rurale, nëse nuk janë të lidhura me prodhimin primar. Lejohet përdorimi me densitet të lartë të tokës dhe përdorimi me densitetit të ulët. Kjo klasë përfshin, gjithashtu, zona banimi të përziera me përdorime të tjera jokonfliktuale me banimin, si edhe zona të përdorura përkohësisht për banim.
5_1 -- Emri -- Banim i përhershëm -- Përkufizimi -- Zonat e banimit të dominuara nga shtëpitë e shkëputura, të rrethuara nga kopshte dhe/ose oborre, përzierje e shtëpive njëfamiljare, shtëpive gjysmë të shkëputura, shtëpive me tarraca, shtëpive të qytetit, shtëpive të rreshtuara dhe blloqeve të banesave të përdorura si vendbanim i përhershëm. --Varësia-- <i>PërdorimBanimi</i>
5_2 -- Emri -- Banim me përdorime të tjera të pajtueshme -- Përkufizimi -- Zonat e banimit të përziera me përdorime të tjera jokonfliktuale (p.sh., shërbime të ndryshme, industri të lehta etj.). --Varësia-- <i>PërdorimBanimi</i>
5_3 -- Emri -- Banim i përkohshëm



Kodlistë
-- Përkufizimi -- Zonat me përdorim të përkohshëm banimi (kampe për e/migrantë), banesa pushimi (shtëpiza verore) etj. --Varësia-- <i>PërdorimBanimi</i>
6_ -- Emri -- Përdorime të tjera -- Përkufizimi -- Sipërfaqe që nuk përfshihen në vlerat e 1_ProdhimParësor, 2_ProdhimDytësor, 1_ProdhimTerciar, 4_RrjetiTransportitLogistikDheShërbimeKomunale, 5_PërdorimBanimi apo në nënvlerat e tyre, si dhe zona në ndërtim.
6_1 -- Emri -- Zonat kalimtare -- Përkufizimi -- Sipërfaqe që ndodhen në ndërtim e sipër. Kjo klasë duhet të përdoret vetëm për përdorimin ekzistues të tokës dhe jo atë të planifikuar. --Varësia-- <i>PërdorimeTëTjera</i>
6_2 -- Emri -- Zona të braktisura -- Përkufizimi -- Sipërfaqe të braktisura bujqësore, industriale, banesa, infrastruktura të transportit. Sipërfaqja klasifikohet te zonat e braktisura nëse nuk është në përdorim dhe nuk mund të përdoret më për qëllimin fillestar pa ndërhyrje të madha apo rikonstruksion. --Varësia-- <i>PërdorimeTëTjera</i>
6_3 -- Emri -- Zona natyrore joekonomike -- Përkufizimi -- Sipërfaqe që janë në gjendje natyrale dhe nuk kanë përdorim tjetër ekonomik. --Varësia-- <i>PërdorimeTëTjera</i>
6_3_1 -- Emri -- Tokë jo ekonomike -- Përkufizimi -- Zonat që janë natyrale, p.sh.: pyjet, shkurret, livadhet, ligatinat, tokat djerrë, të cilat nuk kanë ndonjë përdorim tjetër socioekonomik. Këtu përfshihen zonat që planifikojnë të kenë statusin e zonës natyrore. Zonat e mbrojtura mund t'i përkasin kësaj klase ose mund të klasifikohen në klasa të tjera nëse kanë përdorime të tjera. Zonat e mbrojtura specifikohen gjithmonë me statusin që kanë dhe rregulloren shtesë që i shoqëron. --Varësia-- <i>ZonaNatyroreJoEkonomike</i>
6_3_2 -- Emri -- Ujëra pa përdorim ekonomik -- Përkufizimi -- Sipërfaqe ujore të cilat nuk kanë përdorime të tjera socioekonomike (p.sh.: liqene, lumenj, dhe zona të mbuluara me borë ose akull). --Varësia-- <i>ZonaNatyroreJoEkonomike</i>
6_4 -- Emri -- Zonë ku lejohet çdo përdorim -- Përkufizimi -- Sipërfaqe ku çdo përdorim lejohet në planifikimin e përdorimit të tokës.



Kodlistë
--Varësia-- <i>PërdorimeTëTjera</i>
6_5 -- Emri -- Zonë pa ndonjë përdorim të caktuar të planifikuar
-- Përkufizimi -- Sipërfaqe ku plani nuk ka dhënë asnjë përdorim të planifikuar të tokës (PPT), p.sh., sipërfaqe jashtë qëllimit të planit.
--Varësia-- <i>PërdorimeTëTjera</i>
6_6 -- Emri -- Pa përdorim
-- Përkufizimi -- Zona ku përdorimi i tokës është i panjohur.
--Varësia-- <i>PërdorimeTëTjera</i>

4.4 KODLISTAT PËR NËNTEMËN “PLANIFIKIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS”

4.4.1 VLERAT E NIVELIT TË PLANIT GJEOHAPËSINOR

-- Emri --

Niveli i planit gjeohapësinor

-- Përkufizimi --

Hierarkia territoriale e planit.

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë janë vetëm vlerat e specifikuara më poshtë në tabelë.

KodListë
-- Emri -- Nënvendor
-- Përkufizimi -- Plani mbulon vetëm një pjesë të territorit të bashkisë.
-- Emri -- Vendor
-- Përkufizimi -- Plani në nivel bashkie, që korrespondon me nivelin më të ulët të administrimit të barasvlershme me LAU2, siç përcaktohet në aneksin III të rregullores (CE) nr. 1059/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (OJ L 154, 21.6.2003, f.).
-- Emri -- Mbivendor
-- Përkufizimi -- Plani mbulon disa bashki (tërësisht ose pjesërisht).
-- Emri -- Nënrajonat
-- Përkufizimi -- Plani mbulon disa njësi administrative në një rajon administrativ.
-- Emri -- Rajonal
-- Përkufizimi -- Plani në nivel rajonal (ekuivalent me NUTS2 të nomenklaturës EUROSTAT të njësive statistikore, siç përcaktohet në



KodListë
rregulloren (CE) nr. 1059/2003).
-- Emri -- Mbirajonal
-- Përkufizimi -- Plani mbulon disa rajone administrative.
-- Emri -- Kombëtar
-- Përkufizimi -- Plani në nivelin e shtetit anëtar.
-- Emri -- Planifikimi në nivel qendror
-- Përkufizimi -- Plani në nivel qendror përfshin: - Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT); - Planet kombëtare sektoriale (PKS). Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare (PDZRK).
-- Emri -- Planifikimi në nivel vendor
-- Përkufizimi -- Planifikimi në nivel vendor përfshin: - Planet sektoriale në nivel qarku (PSNQ); - Planet e përgjithshme vendore (PPV); - Planet sektoriale në nivel bashkie (PSNB).
-- Emri -- Tjetër
-- Përkufizimi -- Niveli tjetër plani gjeohapësinor.

4.4.2 VLERAT E PËRGJITHSHME TË HAPIT TË PROCESIT

-- Emri --

Hapi i përgjithshëm i procesit

Kodlistë
-- Emri -- Miratim
-- Përkufizimi -- Plan në procesin e miratimit ligjor.
-- Emri -- Hartim
-- Përkufizimi -- Plani në procesin e hartimit.
-- Emri -- Në fuqi
-- Përkufizimi -- Plan i miratuar dhe ligjërishit i detyrueshëm ose aktiv.
-- Emri -- Shfuqizuar
-- Përkufizimi -- Plani është zëvendësuar me një plan tjetër ose nuk është më në fuqi.



-- Emri --

I rishikuar

-- Përkufizimi --

Plani është rishikuar.

-- Emri --

I korrigjuar

-- Përkufizimi --

Plani është korrigjuar.

-- Përkufizimi --

Treguesi i përgjithshëm që tregon hapin e procesit të planifikimit që po kalon plani.

-- Përshkrimi --

Shënim. Ky numërim përmban vlera që janë të përbashkëta për shumicën e sistemeve të planifikimit.

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë listë kodesh janë vetëm vlerat e specifikuara më poshtë në tabelë.

4.4.3 VLERAT E NATYRËS SË RREGULLORES

-- Emri --

Natyra e rregullores

-- Përkufizimi --

Natyra ligjore e treguesit të përdorimit të tokës.

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë janë vetëm vlerat e specifikuara më poshtë në tabelë.

Kodlistë

-- Emri --

I detyrueshëm për zhvilluesit

-- Përkufizimi --

Treguesi i përdorimit të tokës është i detyrueshëm vetëm për entitetin përgjegjës për zhvillimin e një zone.

-- Emri --

I detyrueshëm vetëm për autoritetet

-- Përkufizimi --

Treguesi i përdorimit të tokës është i detyrueshëm vetëm për disa autoritete.

-- Emri --

Përgjithësisht i detyrueshëm

-- Përkufizimi --

Treguesi i përdorimit të tokës është i detyrueshëm për të gjithë.

-- Emri --

Jo i detyrueshëm

-- Përkufizimi --

Treguesi i përdorimit të tokës nuk është i detyrueshëm.

-- Emri --

I përcaktuar në legjislacion

-- Përkufizimi --

Treguesi i përdorimit të tokës përcaktohet nga legjislacioni.



4.4.4 VLERAT E RREGULLORES PLOTËSUESE

-- Emri --

Rregulla shitesë

-- Përkufizimi --

Llojet e kushteve dhe kufizimeve në planet gjeohapësinore.

-- Përshkrimi --

Llojet e kushteve dhe kufizimeve në planet gjeohapësinore.

-- Vlerat --

Vlerat e lejuara për këtë kodlistë janë të gjitha vlerat të përcaktuar nga ofruesit e të dhënave.

Kodlistë
1_ -- Emri -- Impakti në mjedis -- Përkufizimi -- Rregullore shitesë që lidhet me ndikimin në mjedis, siç përcaktohet nga autoriteti kompetent dhe si pjesë e raportit të planit gjeohapësinor.
1_1 -- Emri -- Zona e menaxhimit të zhurmës -- Përkufizimi -- Zonë ku janë vendosur masat për zbutjen e ndotjes akustike nga zhurmat. -- Përshkrimi -- Shënim. Zonat ose sipërfaqet e menaxhimit të zhurmës mund të përfshijnë territoret që rrethojnë aeroportet, rrugët ose objektet argëtuese (nga AM DS V2.0). --Varësia-- <i>ImpaktiNëMjedis</i>
1_1_1 -- Emri -- Zona e mbrojtjes nga zhurma -- Përkufizimi -- Zona brenda së cilës janë miratuar masa specifike në lidhje me mbrojtjen kundër zhurmës. --Varësia-- <i>ZonaMenaxhimitTëZhurmës</i>
1_2 -- Emri -- Zona e kontrollit të emetimeve -- Përkufizimi -- Një zonë ku janë vendosur masa për të kontrolluar ndotjen e ajrit. --Varësia-- <i>ImpaktiNëMjedis</i>
1_2_1 -- Emri -- Zona e menaxhimit të cilësisë së ajrit -- Përkufizimi -- Një pjesë e territorit të një shteti anëtar, i përcaktuar nga shteti anëtar për qëllime të vlerësimit dhe të menaxhimit të cilësisë së ajrit. -- Përshkrimi -- Burimi: Direktiva CAFE (2008/50 / EC)
1_3 -- Emri --



Kodlistë

Zona për energjinë e rinovueshme

-- Përkufizimi --

Zonë e përshtatshme për energji të rinovueshme.

--Varësia--

ImpaktiNëMjedis

1_4

-- Emri --

Mbrojtja e natyrës

-- Përkufizimi --

Zonë që lidhet me mbrojtjen e natyrës.

--Varësia--

ImpaktiNëMjedis

1_4_1

-- Emri --

Korridori ekologjik

-- Përkufizimi --

Zona e habitatit që lidh kafshët e egra, të ndara nga aktivitetet njerëzore (siç janë rrugët, zhvillimet ose transportet).

--Varësia--

MbrojtjaNatyres

1_4_2

-- Emri --

Rezervuari i biodiversitetit

-- Përkufizimi --

Zonë gjeografike me një rezervuar të rëndësishëm të biodiversitetit që është nën kërcënim nga njerëzit.

--Varësia--

MbrojtjaNatyres

1_4_3

-- Emri --

Zonë e mbrojtur e pyllëzuar

-- Përkufizimi --

Zonë e pyllëzuar që është e mbrojtur.

--Varësia--

MbrojtjaNatyres

1_4_4

-- Emri --

Zona e mbrojtur urbane, periurbane, bujqësore ose natyrore

-- Përkufizimi --

Tokë bujqësore ose natyrore në hapësirën urbane ose periurbane e cila është e mbrojtur.

--Varësia--

MbrojtjaNatyres

1_4_5

-- Emri --

Ligatinat e mbrojtura

-- Përkufizimi --

Zona ku faktori kryesor i ndikimit në habitatin dhe botën e tij është toka e lagur që është e mbrojtur.

--Varësia--



Kodlistë
<i>Mbrojtja Natyrës</i> 1_4_6 -- Emri -- Zona e mbrojtjes së shëndetit të bimëve -- Përkufizimi -- Zona mbrojtur brenda së cilës vendosen masa mbrojtëse kundër futjes së organizmave të dëmshëm për bimët ose produktet bimore, si dhe përhapjes së tyre. -- Përshkrimi -- Burimi: Rregullorja e Komisionit (CE) nr. 690/2008. --Varësia-- <i>Mbrojtja Natyrës</i>
1_4_7 -- Emri -- Zona të tjera të mbrojtura natyrore -- Përkufizimi -- Zonë e cila ka të bëjë me mbrojtjen e llojeve të tjera natyrore. --Varësia-- <i>Mbrojtja Natyrës</i>
1_5 -- Emri -- Mbrojtja e klimës -- Përkufizimi -- Një zonë ku janë krijuar masa për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. --Varësia-- <i>Impakti Në Mjedis</i>
1_6 -- Emri -- Mbrojtja e ujit -- Përkufizimi -- Një zonë ku janë krijuar masa për të mbrojtur ujin. --Varësia-- <i>Impakti Në Mjedis</i>
1_6_1 -- Emri -- Ujëra të përcaktuara -- Përkufizimi -- Marina, vija bregdetare ose sipërfaqe ujore të përcaktuara nga shtetet anëtare, si zona që kanë nevojë për mbrojtje ose përmirësim me qëllim mbështetjen e gjallesave ujore dhe peshqve. -- Përshkrimi -- Shënim. Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë ujërat për të mbrojtur peshqit e ujërave të ëmbla dhe molusqet, që rrjedhin nga direktiva e peshkimit (2006/44 / EC) dhe direktiva e ujërave të detit (2006/113/EEC), (nga AM DS V2.0). --Varësia-- <i>Mbrojtja Ujit</i>
1_6_2 -- Emri -- Zonë e ndjeshme me nitrate -- Përkufizimi -- Sipërfaqet e tokës bujqësore që kullojnë në ujëra të kërcënuara ose të ndotura, duke kontribuar kështu në ndotjen me nitrate të ujit.



Kodlistë

-- Përshkrimi--

Burimi: Neni 3 i direktivës së Këshillit 91/676/EEC të 12 dhjetorit 1991, në lidhje me mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat e përdorura në bujqësi.

--Varësia--

MbrojtjaUjit

1_6_3

-- Emri --

Zonë e ndjeshme

-- Përkufizimi --

Zonat e ndjeshme janë ujërat sipërfaqësore (ujërat e ëmbla, grykëderdhjet dhe vijat bregdetare), që kërkojnë mbrojtje nga eutrofikimi.

-- Përshkrimi--

Burimi: Direktiva e trajtimit të ujërave të ndotura urbane (91/271/EEC).

--Varësia--

MbrojtjaUjit

1_6_4

-- Emri --

Ujëra për banjë

-- Përkufizimi --

Ujërat bregdetare ose ujërat e brendshme (lumenjtë, liqenet) të autorizuar në mënyrë eksplicite ose jo të ndaluara, për përdorim rekreativ nga një numër i madh njerëzish.

-- Përshkrimi--

Shënim. Ujërat për banjë kanë kufij për parametrat fizikë, kimikë dhe mikrobiologjikë për të siguruar ujëra të pastra për larje, për të mbrojtur shëndetin publik dhe mjedisin (nga AM DS V2.0).

--Varësia--

MbrojtjaUjit

1_6_5

-- Emri --

Zona e mbrojtjes së ujit të pijshëm

-- Përkufizimi --

Sipërfaqe në të cilën ndalohet kullimi i ujërave të ndotura, përdorimi i plehut ose pesticideve, ose vendosja e vendgrumbullimeve të mbeturinave.

-- Përshkrimi--

Shëmbull: Nga direktiva 80/778, në lidhje me cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Sipas nenit 8, parashikohet që shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që çdo substancë e përdorur në përgatitjen e ujit për konsum njerëzor nuk kanë përqendrim më të larta se sa maksimumi i pranueshëm (nga AM DS V2.0).

--Varësia--

MbrojtjaUjit

1_7

-- Emri --

Zona e menaxhimit të pyjeve

-- Përkufizimi --

Zona e caktuar për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe funksioneve.

--Varësia--

ImpaktiNëMjedis

1_8

-- Emri --

Ndikim tjetër në mjedis

-- Përkufizimi --

Rregulla shpesh të tipave të tjerë, që lidhen me ndikimin në mjedis, siç përcaktohen nga autoritetet kompetente dhe janë pjesë e raportit të planit gjeohapësinor.

--Varësia--

ImpaktiNëMjedis



Kodlistë
2_ -- Emri -- Ekspozim ndaj rrezikut -- Përkufizimi -- Rregullore shtesë lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut të çdo natyre të përcaktuar nga një autoritet kompetent dhe të raportuar në planin gjeohapësinor -- Përshkrimi-- Shënim 1. Ngjarjet e shumta natyrore paraqesin rrezik për gjallesat, ambiente të ndërtuara dhe natyrore, meqenëse ato kërcënojnë jetën e njerëzve dhe të kafshëve dhe mund të shkaktojnë dëme serioze për vendbanimet. Për këtë arsye, vendbanimet njerëzore duhet të mbrohen sa më shumë që të jetë e mundur nga rreziqet me anë të masave parandaluese të përshtatura. Sipas intensitetit, ndikimeve dhe dëmtimeve të shkaktuara, këto ngjarje natyrore (ose rreziqe) mund të konsiderohen si fatkeqësi natyrore, prandaj një fatkeqësi natyrore është pasojë e kombinimit të një rreziku natyror dhe aktiviteteve njerëzore. Rreziqet kryesore natyrore janë: ortehtë, thatësirat, tërmetet, përmytjet, rrëshqitjet e tokës, shpërthimet vullkanike, tsunami, tornadot, ciklonet, zjarret etj. Shënim 2. Rreziku teknologjik. Një rrezik teknologjik lidhet domosdoshmërisht me aktivitetet njerëzore në fushën e prodhimit të energjisë, transportit, ndërtesave, punëve publike etj. Rreziqet për shkak të aktiviteteve industriale ose nukleare, minierave dhe nëntokës ose rreziqet për shkak të transportimit të substancave të rrezikshme (nga toka, lumi apo deti), ose kërcënimi i prishjes së digës, të gjitha këto konsiderohen si rreziqe të mëdha teknologjike. Burimi: CEMAT.
2_1 -- Emri -- Rreziku nga përmytjet -- Përkufizimi -- Rregullore shtesë lidhur me ekspozimin ndaj Përmytjes --Varësia-- <i>EkspozimNdajRrezikut</i>
2_1_1 -- Emri -- Zonë e ekspozuar ndaj rrezikut të përmytjes -- Përkufizimi -- Zonë e përcaktuar si e ekspozuar ndaj rrezikut nga përmytjet. --Varësia-- <i>RrezikuNgaPërmytjet</i>
2_1_2 -- Emri -- Zonë e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet -- Përkufizimi -- Zonat bregdetare ose basenet individuale të lumenjve të caktuara si njësi të menaxhimit për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut nga përmytjet. -- Përshkrim-- Shënim. Këto janë zona bregdetare ose basene individuale lumenjsh të caktuara si njësi të menaxhimit të ndryshme nga ato të caktuara sipas nenit 3 (1) të direktivës 2000/60/EC. BURIMI: 2007/60/EC neni 3 (2) b. --Varësia-- <i>RrezikuNgaPërmytjet</i>
2_2 -- Emri -- Rrezik industrial -- Përkufizimi -- Zonë në rrezik të ekspozimit të materialit të rrezikshëm. -- Varësia -- <i>EkspozimNdajRrezikut</i>



Kodlistë
2_2_1 -- Emri -- Plumb -- Përkufizimi -- Zona në rrezik ekspozimi ndaj plumbit -- Burimi -- <i>RrezikIndustrial</i>
2_2_2 -- Emri -- Zonat e përjashtimit rreth territoreve të ndotura -- Përkufizimi -- Zonat e krijuara për të mbrojtur shëndetin e njeriut, bimëve dhe kafshëve, si dhe kontrollin e lëvizjes dhe të zhvillimit brenda një vendi të kontaminuar. -- Përshkrim -- Shembulli 1. Zona e Përjashtimit e Termocentralit Bërthamore të Çernobilit, e cila u krijua për të evakuuar popullatën lokale dhe për të parandaluar njerëzit që të hyjnë në territorin e kontaminuar. Shembulli 2. Zona e krijuar rreth një territori që vuan nga ndotja e tokës për të kufizuar zhvillimin dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut (nga AM DS V2.0). --Varësia-- <i>RrezikIndustrial</i>
2_2_3 -- Emri -- Tokë “ngjyrë kafe” -- Përkufizimi -- Tokë “ngjyrë kafe” është toka e përdorur më parë për qëllime industriale ose përdorime të caktuara komerciale dhe që mund të jetë e kontaminuar me përqendrime të ulëta të mbetjeve të rrezikshme ose ndotjeve dhe ka potencial që të ripërdoret sapo të pastrohet, rigjenerohet. Ndonjëherë, koncepti i tokës <i>brownfield</i> është përdorur edhe për përcaktimin e zonave, të cilat janë zhvilluar më parë dhe janë tjetërsuar, por jo domosdoshmërisht të kontaminuara. -- Përshkrimi-- Burimi: Fjalori i zhvillimit hapësinor, Konferenca Evropiane e Ministrave Përgjegjës për Planifikimin Gjeohapësinor/Rajonal (CEMAT). --Varësia-- <i>RrezikIndustrial</i>
2_2_4 -- Emri -- Zonat e përjashtimit rreth territoreve Seveso -- Përkufizimi -- Zonë brenda një distance rregullatore nga një vend i klasifikuar si Seveso. --Varësia-- <i>RrezikIndustrial</i>
2_3 -- Emri -- Minierat -- Përkufizimi -- Zonë e cila është e përcaktuar si e ekspozuar ndaj rreziqeve të minierave. --Varësia-- <i>EkspozimNdajRreziqut</i>
2_4 -- Emri --



Kodlistë
Erozioni
-- Përkufizimi -- Zonë e cila është e përcaktuar si e ekspozuar ndaj rrezikut të erozionit.
-- Varësia -- <i>EkspozimNdajRrezikut</i>
2_5
-- Emri -- Ekspozim ndaj rreziqeve të tjera
-- Përkufizimi -- Zonë e përcaktuar si e ekspozuar ndaj rreziqeve të tjera.
-- Varësia -- <i>EkspozimNdajRrezikut</i>
3_
-- Emri -- Mbrojtja e trashëgimisë
-- Përkufizimi -- Rregullore shitesë që ka të bëjë me çdo mbrojtje të trashëgimisë qoftë natyrore, peizazh apo ndërtim, siç përcaktohet nga një autoritet kompetent dhe është pjesë e raportit të planin gjeohapësinor.
